STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

**Për Njoftim të Menjëhershëm:** 12 shkurt 2013

**GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE HETIMI I ADMINISTRATES ZBULON TE PAKTEN 200 MILIONE DOLLARE NE FONDE TË SIGURIMIT PËR SENDIN (SANDY) NUK JANE DHENE NGA BANKAT PER PRONARET E SHTEPIVE**

***U bën thirrje bankave, Fannie Mae dhe Freddie Mac të përshpejtojnë procesin për të lejuar riparimet e nevojshme***

***Zbulohet se katër bankat më të mëdha të vendit, Wells Fargo, Bank of America, Citibank dhe JP Morgan Chase, mbajnë më shumë se 4,000 çeqe të ndihmës me vlerë më shumë se 130 milionë dollarë***

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se një hetim i Departamentit të Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) zbuloi 200 milionë dollarë në fonde të sigurimeve nga super stuhia Sendi (Sandy) që po mbahen nga bankat dhe nuk u janë dërguar ende pronarëve të shtëpive, të cilëve u nevojiten paratë për të paguar për riparimet e nevojshme.

Administrata Kuomo (Cuomo) u ka dërguar letra bankave dhe agjencive të hipotekave duke u kërkuar që të përdorin aftësitë vendim-marrëse dhe përpjekjet maksimale për të përshpejtuar dhënien e fondeve. Departamenti gjithashtu u ka dërguar letra Fannie Mae dhe Freddie Mac duke kërkuar reforma urgjente të rregullave dhe praktikave të tyre në lidhje me dhënien e fondeve të sigurimit nga bankat dhe agjencitë e hipotekave.

“Familjet kanë nevojë të jenë në gjendje që të kthehen në shtëpitë e tyre dhe ekonomia e Shtetit, e cila u godit nga super stuhia Sendi (Sandy), ka nevojë për nxitjen nga shpenzimet për riparime. Pasi ndërmarrjet e sigurimeve u kanë dërguar pronarëve të shtëpive çeqet për të paguar për riparimet, paratë nuk duhet të qëndrojnë në bankë për shkak të burokracisë,” tha Guvernatori Kuomo (Kuomo). “Bankat duhet të përdorin aftësitë vendim-marrëse maksimale për të kaluar paratë në duart e pronarëve të shtëpive sa më shpejt që të jetë e mundur.”

Kryeinspektor i DFS-së Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky) tha, “Në dhjetor arritëm një marrëveshje me bankat që rezultoi në dhënien e një pjese të fondeve të sigurimit. Por tani shohim se paratë ende nuk po kalojnë aq shpejt sa u duhen pronarëve të shtëpive. Ndërsa e kuptojmë se ka disa kufij sesi bankat japin fondet, dëshirojmë të sigurohemi se po i shtyjnë ato kufij dhe po japin paratë e

sigurimit shpejt. Do të punojmë me Fannie Mae dhe Freddie Mac për të pakësuar pengesat për rrjedhjen e fondeve të sigurimit."

Shumë viktima të stuhisë Sendi që marrin çeqe të sigurimit përballen me një pengesë që shpesh nuk e kishin parashikuar: çeku është lëshuar së bashku për pronarin e shtëpisë dhe për bankën ose agjencinë e hipotekës të pronarit të shtëpisë, duke kërkuar kështu që miratimin e bankës për çekun përpara sesa pronari i shtëpive të mund të përdorë fondet. Ky miratim i dyfishtë është një kërkesë standarte e dokumentave të hipotekës dhe kontratave të sigurimit.

Përpara sesa bankat të japin paratë, ato mund të kërkojnë provë të punës së riparimit, sipas rregullave të agjencive federale të hipotekave, Fannie Mae dhe Freddie Mac. Kjo ka shkaktuar vonesa në marrjen nga pronarët e shtëpive të parave që u duhen për të bërë riparime në shumë raste, në mënyrë që të mund të kthehen në shtëpitë e tyre.

DFS ka marë qindra ankesa nga banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) të zemëruar nga dështimi i bankës ose agjencisë së hipotekës së tyre për të dhënë këto të ardhura nga sigurimi. Pronarët e shtëpive thonë se bankat kanë qënë ose shumë të ngadalta në përpunimin e dokumentave ose kanë vendosur shumë kushte për pronarët e shtëpive përpara dhënies së fondeve, duke rezultuar kështu në vonesa në riparimin e shtëpive.

Departamenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) ka vëzhguar agjencitë e hipotekave në lidhje me sasinë e kërkesave për sigurim që po mbajnë. Deri në fund të janarit, 27 agjenci të shërbimeve që përfaqësojnë 95% të tregut të Nju Jorkut (New York) po mbanin të ardhura për 6,611 huamarrës për gjithsej rreth 208 milionë dollarë. Katër bankat më të mëdha, Wells Fargo, Bank of America, Citibank dhe JP Morgan Chase, po mbajnë 4,159 çeqe me vlerë 131 milionë dollarë.

Këto numra janë në rritje pasi më shumë çeqe sigurimi po lëshohen dhe ndërsa bankat përcaktojnë se më shumë riparime të pronarëve të shtëpive duhet të mbikqyren mëqënse tani më shumë para janë në lojë për këta pronarë të shtëpive.

Në dhjetor, Departamenti dhe bankat kryesore arritën një marrëveshje që e përmirësoi gjendjen duke përshpejtuar çeqet paraprake për pronarët e shtëpive, por ndërsa po lëshohen çeqe më të mëdha të sigurimit, bankat dhe agjencitë e hipotekave ende janë duke mbajtur një sasi të konsiderueshme të parave dhe hezitojnë të japin këto para pa verifikimin se riparimet po bëhen. Bankat përmendin më shpesh udhëzimet e Fannie Mae dhe Freddie Mac si arsyet se nuk janë në gjendje të japin më shumë fonde.

Departamenti beson se për pronarët e shtëpive që kanë paguar hipotekat e tyre dhe që nuk pësuan humbje të plotë ose pothuajse të plotë, bankat duhet të kenë aftësi vendim-marrëse të konsiderueshme për të dhënë fonde. Administrata Kuomo (Cuomo) është duke diskutuar me agjencitë federale të hipotekave për të sqaruar rregullat e tyre.

Albanian

Në një letër drejtuar bankave dhe agjencive të hipotekave, Departamenti propozoi praktikat më të mira të mëposhtme për të përshpejtuar dhënien e fondeve. Bankat dhe agjencitë duhet të:

1. Botojnë informacion të qartë, lehtësisht të disponueshëm në faqet e tyre në internet, duke përshkruar procedurat që kërkohen për të dhënë fonde, të sigurojnë kopje të formularëve të kërkuar dhe të rendisin informacionin e kontaktit për përfaqësuesit e konsumatorëve.
2. Caktojnë një pikë të vetme kontakti për pronarët e shtëpive.
3. Japin menjëherë të gjitha fondet e caktuara nga ndërmarrja e sigurimit si fonde "urgjente" ose "paraprake".
4. Lejojnë paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar nëpërmjet faksit dhe e-mailit. Fakset dhe e-mailat që kanë lidhje me stuhinë Sendi (Sandy) duhet të kenë një numër të veçantë, të caktuar faksi dhe adresë e-maili për të përshpejtuar përpunimin.
5. Minimizojnë sasinë e dokumentacionit të kërkuar gjatë secilës fazë të riparimit.
6. Mbajnë të gjitha të ardhurat nga sigurimi në një llogari escrow që jep interes në përfitim të pronarit të shtëpisë.
7. Përpunojnë të gjithë postën në ditën e marrjes.
8. Pas marrjes së dokumentacionit të plotë, të japin të ardhura ditën e marrjes.
9. Në rastin kur marrin dokumentacion jo të plotë, të njoftojnë pronarin e shtëpisë menjëherë me udhëzime të hollësishme mbi kërkesat shtesë.
10. Për ato me degë, të pranojnë dokumentat dhe të miratojnë çeqet në të gjitha vendndodhjet e degëve.
11.Kur të ardhurat nuk mund të jepen personalisht në një vendndodhje të degës, të japin fonde përmes transferës elektronike ose dërgesës gjatë natës.
12. Kërkojnë kontroll vetëm kur kërkohet posatçërisht nga udhëzimet e investitorit.
13. Atje ku kërkohet kontroll, të dërgojnë inspektorë brenda dy ditësh nga marrja e dijenisë për kërkesën e pronarit të shtëpisë për një inspektim të tillë.
14. Të kryejnë të gjitha kontrollet me shpenzimet e vetë agjencisë.
15. Pas marrjes së provës se pronari i shtëpisë është duke kërkuar vetëm rimbursim për para të shpenzuara tashmë në riparime të shtëpisë, të japin çekun ose transfertën elektronike drejtpërdrejt dhe ekskluzivisht për pronarin e shtëpisë.
16. Kenë personel të mjaftueshëm për të vepruar në përputhje me të gjitha praktikat e mësipërme.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418